



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 478/9 prot.

Datë 03.03.2026

**V E N D I M**

**Nr. 330/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.03.2026 me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik BOE “Idealdevs Corporation” SHPK & “Ervald Rosaj” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02-02-2026 , nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durres.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Lënien të skualifikuar të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “IdealDevs Corporation” shpk, “Pc store” shpk, “ATOM” shpk, “OPTIMA COMMUNICATION” sh.p.k, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Lënien të skualifikuar të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “IdealDevs Corporation” shpk, “Pc store” shpk, “ATOM” shpk, “Instant” sh.p.k, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK dhe operatorit ekonomik “PC Store” në procedurën e mësipërme të prokurimit.

**Autoriteti Kontraktor:** Autoriteti Portual Durrës me adresë: Lagja 1, Rruga Tregtare, Durrës..

**Ankimues:** Operatori ekonomik BOE “Idealdevs Corporation” SHPK & “Ervald Rosaj” SHPK me NIPT M38106801F, me adresë: BARAJ 01960008 Nd. 64, H. 1, Mallakastër.

Operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK, me NIPT (L81506043D) dhe adresë: Rr. Ali Demi perballe Fushes se Zeze, Tirane, Tirane zona kadastrale 8150 ,numri i pasurise 8/801.

Operatori ekonomik “PC STORE” SHPK me NIPT L01606034A, me adresë: Rruga e Dibres, Vila nr.153, Kati i Pare.

“OPTIMA COMMUNICATION” Sh.p.k me Nipt K71903025A dhe Adresë: Rruga Shyqyri Berxolli, Pallati Inter Co-Sat, Seksioni B, Kati i 6.

**Subjekt i interesuar:** “Idealdevs Corporation” SHPK & “Ervald Rosaj” SHPK me NIPT M38106801F, me adresë: BARAJ 01960008 Nd. 64, H. 1, Mallakastër.

“PC STORE” SHPK me NIPT L01606034A dhe adresë Rruga e Dibres, Vila nr.153, Kati i Pare.

“OPTIMA COMMUNICATION” Sh.p.k me Nipt K71903025A dhe Adresë: Rruga Shyqyri Berxolli, Pallati Inter Co-Sat, Seksioni B, Kati i 6....

Operatori ekonomik “Atom” SHPK me NIPT L22203042N dhe adresë: Njesia Bashkiake Nr.10, Rruga Islam Alla, Pallati Nr.56, Kati i 1, Tiranë.

Operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK, me NIPT (L81506043D) dhe adresë: Rr. Ali Demi perballe Fushes se Zeze, Tirane, Tirane zona kadastrale 8150 ,numri i pasurise 8/801.

**Baza Ligjore:**

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

1.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

1.5. Ankimuesit kanë plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 05-12-2025 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durres.

II.2. Në datën 02.02.2026, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor më datë 09.02.2026, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE “Idealdevs Corporation” SHPK & “Ervald Rosaj” SHPK	9343900.00 lekë Skualifikuar
2. “PC STORE” SHPK	9600000.00 lekë Skualifikuar
3. “ATOM” SHPK	11800000.00 lekë Skualifikuar
2. “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK	12400000.00 lekë Skualifikuar
4. “INSTANT.AL” SHPK	13270000.00 lekë Skualifikuar
6. “Cactus” SH.A	13524753.67 lekë Skualifikuar

II.4 Në datën 11.02.2026, autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit dhe nëpërmjet Buletini Nr. 14 datë 16 Shkurt 2026 të APP, me arsyen e anulimit:

*X në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme.*

II.5. Në datën 15.02.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. 478/2026 protokoli, datë 16.02.2026 e operatorit ekonomik BOE “Idealdevs Corporation” SHPK & “Ervald Rosaj” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02-02-2026 , nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durres.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.478/1 prot, datë 16.02.2026, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik BOE “Idealdevs Corporation” SHPK & “Ervald Rosaj” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se me shkresën e protokolluar me tonën nr.478/2, datë 17.02.2026, janë dorëzuar informacione shtesë nga operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK. Gjithashtu me shkresën nr.4283/31, datë 17.02.2026 protokolluar me tonën nr.478/3, datë 17.02.2026, janë dorëzuar argumente shtesë nga operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK.

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se ne datë 20.02.2026 me shkresën e protokolluar me tonën nr.478/4, datë 23.02.2026, janë dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve argumente nga operatori ekonomik “PC Store” SHPK, në përputhje me nenin 113 të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar për procedurën e prokurimit.

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se ne datë 20.02.2026 me shkresën e protokolluar me tonën nr.478/5, datë 23.02.2026, janë dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve argumente nga operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK, në përputhje me nenin 113 të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar për procedurën e prokurimit.

II.10. Autoriteti kontraktor nëpërmjet shërbimit postar, ka përcjellë me shkresën nr. 703 prot., datë 26.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 478/6 prot., datë 02.03.2026, vendimin e KSHA-së, mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues BOE “Idealdevs Corporation”

SHPK & “Ervald Rosaj” SHPK. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur refuzimin e ankesës.

II.11. Në datën 17.02.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6336 dhe me nr. 494/2026 prot., datë 17.02.2026 e operatorit ekonomik “INSTANT.AL” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02-02-2026 , nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durres.

II.12. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.494/1 prot, datë 17.02.2026, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “INSTANT.AL” SHPK si dhe lënien të skualifikuar të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “IdealDevs Corporation” shpk, “Pc store” shpk, “ATOM” shpk, “OPTIMA COMMUNICATION” sh.p.k, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.13. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se ne datë 20.02.2026 me shkresën e protokolluar me tonën nr.494/2, datë 23.02.2026, janë dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve argumente nga operatori ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK, në përputhje me nenin 113 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar për procedurën e prokurimit.

II.14. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se ne datë 20.02.2026 me shkresën e protokolluar me tonën nr.494/3, datë 23.02.2026, janë dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve argumente nga operatori ekonomik “IdealDevs Corporation” SHPK, në përputhje me nenin 113 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar për procedurën e prokurimit.

II.15. Autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit, ka përcjellë me shkresën nr. 704 prot., datë 26.02.2026, protokolluar me tonën me nr.494/4 prot., datë 02.03.2026, vendimin e KSHA-së së bashku me dokumentacionin bashkëlidhur, mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “INSTANT.AL” SHPK. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur mos pranimin e ankesës se sipërcituar.

II.9. Në datën 17.02.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. 499/2026 protokoll, datë 17.02.2026 e operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me

fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02-02-2026 , nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durres.

II.16. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.499/1 prot, datë 18.02.2026, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.17. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se në datë 20.02.2026 me shkresën e protokolluar me tonën nr.499/2, datë 23.02.2026, janë dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve argumente nga operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK, në përputhje me nenin 113 të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar për procedurën e prokurimit.

II.18. Autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit, ka përcjellë me shkresën nr. 705 prot., datë 26.02..2026, protokolluar me tonën me nr.499/3 prot., datë 02.03.2026, vendimin e KSHA-së së bashku me dokumentacionin bashkëlidhur, mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “PC STORE” SHPK. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur mos pranimin e ankesës së sipërcituar.

II.19. Në datën 17.02.2026 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është protokolluar ankesa me nr. 504/2026, datë 18.02.2026 dhe numër ankimi elektronik A/2026/6339, datë 18.02.2026, e operatorit ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF71079-12- 04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02-02- 2026 , nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durres.

II.20. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.504/1 prot, datë 18.02.2026, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK. Gjithashtu operatori ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK, kërkon lënien të skualifikuar te ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “IdealDevs Corporation” shpk, “Pc store” shpk, “ATOM” shpk, “Instant”

sh.p.k, si dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK dhe operatorit ekonomik “PC Store”, në këtë procedurë prokurimi.

II.21. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se në datë 20.02.2026 me shkresën e protokolluar me tonën nr.504/2, datë 23.02.2026, janë dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve argumente nga operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK, në përputhje me nenin 113 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar për procedurën e prokurimit.

II.22. Autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit, ka përcjellë me shkresën nr. 706 prot., datë 26.02.2026, protokolluar me tonën me nr.504/3 prot., datë 02.03.2026, vendimin e KSHA-së së bashku me dokumentacionin bashkëlidhur, mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur mos pranimin e ankesës së sipërcituar.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me ankesën nr. A/2026/6328 datë 15.02.2026 dhe me nr. protokollit 478/2026 datë 16.02.2026 e BOE “Idealdevs Corporation” SHPK & “Ervald Rosaj” SHPK, për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitura prej tyre, me pretendimin se: *“...Ne interpretim të parashikimeve të mësipërme, konstatojmë që AK për plotësimin e secilit nga kriteret e mësipërme ka kërkuar “paraqitjen dhe plotësimin e formularit të vetdeklarimitë . Vet AK, përcakton qartë se përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës të dorëzuara në rrugë elektronike. Pavarësisht parashikimeve të mësipërme, konstatojmë që Autoriteti Kontraktor ka kryer vlerësim të ofertave në kundërshtim të plotë me procedurën ligjore të sipërdetajuar. AK ka vijuar me vlerësimin dhe interpretimin e tipologjisë së Çertifikimeve të stafit teknik, duke tejkalluar dhe abuzuar me të drejtën e kontrollit, diskrecionit dhe legjitimitetit të vlerësimit të ofertave të paraqitura nga OE pjesëmarrëse. Ky vlerësim në këtë fazë të procedurës së prokurimit bie në kundërshtim të plotë dhe serioz me parashikimet ligjore si dhe me vet kriteret*

e caktuara nga AK, duke përbërë një praktikë riskoze, të pahasur më parë, e cila ngre dyshime mbi ligjshmërinë dhe transparencën e zhvillimit të kësaj procedure. vijimësia e shqyrtimit të tipologjisë së certifikatave përtej kërkesave ligjore, në këtë fazë prokurimi, vendos OE përballë një kërkesë të paparashikuar, dhe të palegjitimuar, duke cënuar kështu në mënyrë të drejtëpërdrejtë parimin e barazisë, transparencës dhe diskrecionit në vlerësimin e ofertave. Vlerësimi se Çertifikatat e paraqitura nga OE nuk janë në përputhje me tipologjinë e Çertifikimeve të kërkuara nga AK, përbën një tejkalim dhe mosrespektim të fazave të procedurës së prokurimit publik, duke na vendosur ne si OE në kushte të disfavorshme dhe të pabarabarta ligjore. Bashkimi i OE, ka paraqitur formularin e vetdeklarimit, i cili përmban të gjitha informacionet e kërkuara nga AK në këtë fazë prokurimi, përkatësisht numrin e punonjësve, tipologjitë e kualifikimeve dhe Çertifikimeve të tyre, konform kërkesave të DST-së dhe rregullimeve ligjore. NË interpretim literal dhe juridik të kësaj dispozite, konstatojmë që OE ofertues nuk ka detyrim të paraqes certifikatat konkrete të kërkuara, por këto të fundit do të jenë objekt vlerësimi në fazën e dytë të kësaj procedure. Rrjedhimisht, vlerësimi i certifikatave të cituara apo ngarkuara në mënyrë vullnetare nga OE në këtë fazë prokurimi, është tërësisht arbitrare dhe nuk gjen asnjë mbështetje ligjore. Për më tepër, skualifikimi i OE pjesëmarrës bazuar në përmbajtjen dhe tipologjinë e këtyre certifikatave është një veprim i cili rëndon edhe më tepër praktikën arbitrare të ndjekur nga AK, në këtë fazë prokurimi. Paraqitja e Çertifikatave përkatëse është një kërkesë e cila aplikohet në fazën e dytë të prokurimit publik dhe nuk mund të kërkohej në mënyrë arbitrare që në këtë fazë. TË gjendur në këto kushte, jemi të paqartë mbi vlerësimin përfundimtar që ka kryer AK, duke tejkaluar dhe anashkaluar procedurën dhe hapat ligjor të zhvillimit të tenderit. Duke shtuar këtu edhe faktin që një interpretim i tillë është aplikuar në mënyrë të përsëritur, për të gjithë OE pjesëmarrës në këtë procedure, përbën një shkelje ligjore të rëndë, e cila dikton patjetër nevojën për interpretim dhe unifikim të praktikës nga KPP, si organi më i lartë administrativ. Siç vërtetohet nga Formulari/Ët bashkëlidhur kësaj ankese, konstatojmë që BOE ka plotësuar të gjitha rubrikat e domosdoshme për të konsideruar këtë formular si të plotë dhe të rregullt. Referuar nenit 26 të VKM-së së nr. 285/2021, rezulton qartë se në fazën e vlerësimit paraprak, Autoriteti Kontraktor dhe KVO duhet të mjaftohen me vetëdeklarimin e operatorit ekonomik, ndërsa verifikimi i plotë me dokumente provuese kryhet vetëm për ofertuesin e renditur i pari, përpara shpalljes së fituesit. Rrjedhimisht, Çdo skualifikim në fazën e vlerësimit paraprak mbi bazën e interpretimit të dokumenteve provuese, pa respektuar fazat e përcaktuara në DST dhe në VKM nr.285/2021, përbën tejkalim të kompetencave dhe cenim të parimit të barazisë dhe proporcionalitetit në këtë procedurë. NË këto kushte, kërkojmë që KSHA dhe Komisioni i Prokurimit Publik të rivendos legjitimitetin dhe barazinë në vlerësimin e ofertave duke konstatuar që kriteri 2.3.3 është përmbushur në përputhje me kërkesat e DST përmes formularit të vetdeklarimit, dhe se Çdo interpretim përtej kësaj faze bie ndesh me procedurën e parashikuar në legjislacionin në fuqi si dhe me vet qëllimin e paraqitjes së formularit të vetdeklarimit. Kryerja e një vlerësimi përtej kornizave ligjore si dhe vet parashikimit të përcaktuar në DST, ku shprehimisht është sanksionuar se verifikimi/vlerësimi i dokumenteve provuese për kriterin 2.3.3 do të kryhet vetëm pasi të shpallet

ofertuesi i renditur i pari (fitues paraprak) dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe në fazën e parë do të mjaftohet me formularin e vetdeklarimit, vjen haptazi në shkelje të procedurës ligjore. NË kundërshtim me parashikimet e vendosura nga vet AK, konstatojmë që KVO ka kryer vlerësimin e dokumentacionit provues në një fazë të parakohshme, pra në momentin e shqyrtimit të ofertës elektronike, duke shkelur haptazi hapat proceduriale ligjor të një procedure prokurimi dhe rrjedhimisht duke passjell skualifikime arbitrare dhe në kundërshtim të plotë me praktikën dhe bazën ligjore në fuqi. Anashkalimi i fazave të vlerësimit si dhe skualifikimi i operatorit ekonomik mbi bazën e një vlerësimi të parakohshëm të dokumenteve të pakërkuara dhe të panevojshme në këtë fazë, përbën tejkalim të kompetencës procedurale dhe cenim të parimit të sigurisë juridike, barazisë në trajtim dhe proporcionalitetit. Rrjedhimisht një vendim i marrë në mënyrë jolegjitime nuk mund të sjellë pasoja legjitime për OE pjesëmarrëse. NË këto kushte, një vendim i marrë në kundërshtim me ligjin, duhet të shpallet automatikisht i pavlefshëm dhe pa pasoja ligjore. Marrja e këtij vendimi përtej hapësirave dhe kufijve ligjorë, prek në mënyrë direkte parimin e sigurisë juridike, barazisë dhe ligjshmërisë në procedurat e prokurimit publik, duke vendosur OE pjesëmarrëse përpara kritereve të panjohura dhe arbitrare. Një vlerësim paraprak dhe përfundimtar i dokumentacionit të tenderit pa i dhënë mundësitë ligjore OE pjesëmarrëse për paraqitje certifikimesh sipas hapave procedural ligjor, përbën një diskriminim dhe përjashtim të padrejtë nga pjesëmarrja në këtë procedurë, dhe zbatimi i këtij vendimi nga AK përbën një precedent të rrezikshëm për ligjshmërinë e procedurave të prokurimit publik. NË të njëjtën linjë me vendimin e mësipërm të marrë nga KPP, vlerësojmë se interpretimi, analizimi dhe vlerësimi i certifikatave të cilat për më tepër janë të panevojshme për t'u paraqitur në këtë fazë të procedurës së prokurimit, përbën tejkalim të kompetencave si dhe shkelje të hapave procedural të zhvillimit të një procedure prokurimi. Për më tepër, argumentimi dhe arsyetimi që KVO ka mbajtur lidhur me certifikatat e paraqitura është i pavlefshëm dhe i paqëndrueshëm, si nga këndvështrimi teknik ashtu edhe nga ai ligjor, Çka do të argumentohet në mënyrë të detajuar në vijim, për të shmangur përsëri një vlerësim dhe qëndrim të dytë nga KVO, ne rast se KPP e pranon ankesën tone.”,

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në pikën 2.3 Kapaciteti teknik, pika 2.3.3, të shtojcës 8, “Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar;

### **“BEHET**

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojë si staf të tij personelin kryesor teknik, si më poshtë:

- a) ***Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për manaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes se***

**ofertave me ofertuesin. Kjo do te vertetohet nga deklarimet E\_SIG te raportuara ne zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet te jene te vlefshme. Nje person mund te disponoje nje ose me shume certifikime.**

*Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzoje dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

- b) Të paktën 1 (nje) specialist të certifikuar për menaxhim projektesh. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes se ofertave me ofertuesin. Kjo do te vertetohet nga deklarimet E\_SIG te raportuara ne zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet te jene te vlefshme. Nje person mund te disponoje nje ose me shume certifikime.**

*Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzoje dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

- c) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për sisteme operative per servera (Windows Server, Linux) në të cilin do të instalohet platforma e Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes se ofertave me ofertuesin. Kjo do te vertetohet nga deklarimet E\_SIG te raportuara ne zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet te jene te vlefshme. Nje person mund te disponoje nje ose me shume certifikime.**

*Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzoje dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

- d) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për baza të dhënash me të cilën do të ndërtohet databaza e platformës të Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët**

**ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes se ofertave me ofertuesin. Kjo do të vertetohet nga deklaratimet E\_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jene të vlefshme. Nje person mund të disponoje nje ose me shume certifikime.**

*Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

- e) Te paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve ëeb/mobile me databazat ekzistuese të institucionit. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes se ofertave me ofertuesin. Kjo do të vertetohet nga deklaratimet E\_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jene të vlefshme. Nje person mund të disponoje nje ose me shume certifikime.**

*Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

- f) Të paktën 2 (dy) specialistë, të certifikuar për zhvillimin e programeve ëeb/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes se ofertave me ofertuesin. Kjo do të vertetohet nga deklaratimet E\_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jene të vlefshme. Nje person mund të disponoje nje ose me shume certifikime.**

*Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

g) *Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për testimin e programeve kompjuterike me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E\_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Nje person mund te disponoje nje ose me shume certifikime.*

*Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.”*

III.1.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, BOE ankimes “Idealdevs Corporation” SHPK & “Ervald Rosaj” SHPK, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

• Operatori ekonomik “Ervald Rosaj” SHPK, Formulari Përmbledhës të Vetdeklarimit, ku për pjesën III “Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit” pika B: “ Deklaratë” Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), ka deklaruar:

<u>Punonjës</u>
Po [ x ] Jo [ ]
Nëse, po, numri i punonjësve:
<b>1 ( Një) punonjës</b>
Profili i punonjësve:
1. Z. <input type="text"/> , me profesion “Inxhinier Softuerik”, i pajisur me: Diplome Universitare

• Operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK, Formulari Përmbledhës të Vetdeklarimit, ku për pjesën III “Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit” pika B: “ Deklaratë” Për disponimin e punonjësve

dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), ka deklaruar:

Profili i punonjësve:

1. **Z.** [ ] me profesion “Programues”, i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e “Programues”, i certifikuar si Analist Biznesi dhe Zhvillues Databaze nga Qendra Alison Empower Yourself.
2. **Z.** [ ] me profesion “Inxhinier Softuerik”, i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e “Administrator” dhe “Inxhinier Softuerik”, i pajisur me certifikimet si: AWS Certified Cloud Practitioner; Fortigate Administrator; Testim Software; Zhvillues Databaze; Siguri Kibernetike; DevOps; AWS Certified Solutions Architect; Menaxher Projekti; Sisteme Operimi, Network, ITIL4; Database Administrator dhe Penetration Testing.
3. **Z.** [ ] me profesion “Inxhinier mekatronik”, i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e “Inxhinier mekatronik”, i certifikuar në Menaxher Projekti, gjuhe programimi Java nga Qendra Communication Progress dhe ISO 27001.
4. **Z.** [ ] me profesion “Inxhinier Software”, i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e “Inxhinier Software”, i certifikuar si Zhvillues Aplikacionesh Javascript, HTML, CSS.
5. **Znj.** [ ] me profesion “Inxhinier Softuerike”, e punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e Inxhinier informatikan, e certifikuar në Penetration Testing Engineer dhe System Administrator( *sisteme operative per servera* )
6. **Z.** [ ] me profesion “Programues”, i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e “Programues”, i certifikuar për Zhvillues Web-i dhe databaze SQL, .NET dhe React JS.
7. **Z.** [ ] me profesion “Inxhinier Software”, i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e “Inxhinier Software”, i certifikuar për Cloud Engineer, Zhvillim Frontend.

8. **Znj.** [ ] e punësuar pranë shoqërisë sonë si “Asistente Zyre”.
9. **Znj.** [ ] me profesion “Inxhinier Software”, e punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e “Inxhinier Software”, e certifikuar në zhvillim Mobile / Web Application (React Native, Node js).
10. **Znj.** [ ] e punësuar pranë shoqërisë sonë si “Inxhinier Softuerike”.
11. **Znj.** [ ] punësuar pranë shoqërisë sonë si “Inxhinier Softuerike”, e certifikuar në JAVA, Testim Softueri, QA.
12. **Z.** [ ] i punësuar pranë shoqërisë sonë si “Inxhinier Softuerik”, i certifikuar për PHP dhe aplikacionesh WEB.
13. **Znj.** [ ] e punësuar pranë shoqërisë sonë si “Inxhinier Softuerike”, e certifikuar për PHP dhe Zhvillim aplikacionesh WEB.

III.1.3 Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet*

*dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

Në nenin 77, pika 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.
- Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre*

*vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e*

*vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë*

*një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

*Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

*III.1.4. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor*

*pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*

*2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:*

*a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

*b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së*

*c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*

*d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*

*dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*

*e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;*

*g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*

*gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;*

***h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);***

*i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;*

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje

me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.6.Nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet, se autoriteti kontraktor në pikën 2.3.3. të “Kapacitetit teknik” ka kërkuar: **2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojë si staf të tij personelin kryesor teknik, si më poshtë:**

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent.**
- b) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për menaxhim projektesh.**
- c) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për sisteme operative për servera (Windows Server, Linux) në të cilin do të instalohet platforma e Portit digjital.**
- d) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për baza të dhënash me të cilën do të ndërtohet databaza e platformës të Portit digjital.**
- e) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve ëeb/mobile me databazat ekzistuese të institucionit.**
- f) Të paktën 2 (dy) specialistë, të certifikuar për zhvillimin e programeve ëeb/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital.**
- g) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për testimin e programeve kompjuterike me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital. Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.”**

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, konkretisht Formularët Përmbledhës të Vetëdeklarimit, konstatohet, se në lidhje me kërkesën për punonjësit sipas profileve të kërkuara në pikën 2.3.3. të kriterëve të veçanata të kualifikimit, BOE ankimues “Idealdevs Corporation” SHPK & “Ervald Rosaj” SHPK ka deklaruar në

Pjesën III: *Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit*, B: *DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme* se ka punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërteton këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, sikurse paraqitet edhe në pikën III.1.2. të këtij vendimi e më konkretisht ankimuesi ka deklaruar: 13 punonjës në total sipas profileve të sipërcituara tek pika III.1.2 e këtij vendimi. Në nenin 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, pika 1 dhe gërma “h” e pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/entit kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:*  
h) *operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti*

Gjithashtu, nga një korrespondencë e mëparshme midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, me shkresën nr. 319/1 prot., datë 19.01.2022 protokolluar me tonën nr. 2472/5 prot., 21.01.2022, Agjencia Prokurimit Publik njofton Komisionin e Prokurimit Publik ndër të tjera se: [...] *Kriteri për kualifikim mbi disponimin e punonjësve, duhet të përmbushet, nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas shtojcës 8 të DST. Qëllimi i paraqitjes së deklaratës “Mbi disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme” në këtë shtojcë, është garantimi i ekzekutimit të kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, pra që operatori ekonomik ka stafin teknik sipas të dhënave të kërkuara. Referuar sa më sipër, plotësimi i kësaj deklarate do të jetë në lidhje me numrin e punonjësve, nëse do të jetë kërkuar, dhe profilin e tyre, sipas kërkesave specifike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të një procedure prokurimi [....].*

Nisur nga sa parashtruar më sipër, korrespondencës së kryer me Agjencinë e Prokurimit Publik, të dhënave të deklaruara nga operatori ekonomik ankimues në Formularin e vetëdeklarimit në pjesën III: “*Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika B Deklaratë “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e shërbimeve objekt - kontrate”*”, Komisioni gjykon se punonjësit e deklaruar të operatorit ekonomik ankimues, kanë të evidentuar të dhënat respektive të kërkuar sipas pikës 2.3.3 të kriterëve të kualifikimit, deklaratë kjo e cila i shërben autoritetit kontraktor për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të kualifikimit për këtë fazë, të vlerësimit të procedurës së prokurimit. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, duhet t’i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së

afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në këtë kuadër, Komisioni gjykon, se deklarimi i punonjësve me të dhënat respektive të kërkuar në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, në stadin në të cilin ndodhet procedura e vlerësimit, sjell përmbushjen e kriterëve të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit në pikën 2.3.3. të kapacitetit teknik. Në përfundim të argumentimit të mësipërm, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga BOE ankimues “Idealdevs Corporation” SHPK & “Ervald Rosaj” SHPK në procedurën e prokurimit në këtë fazë, e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues “Idealdevs Corporation” SHPK & “Ervald Rosaj” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin tjetër të operatorit ekonomik ankimues BOE “Idealdevs Corporation” SHPK & “Ervald Rosaj” sh.p.k, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “Idealdevs Corporation” SHPK & “Ervald Rosaj” SHPK nga procedura e prokurimit objekt - shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë, dhe operatori ekonomik ankimues përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të KPP, do të ndryshojë, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me vlefshmerin e certifikatave në këtë fazë të procedurës KPP nuk mund të shprehet pasi është autoriteti kontraktor i cili do të bëjë rivlerësimin e procedurës në fazat e mëtejshme. KPP risjell në vëmendje se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret kualifikuese në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (vetëm kriteret e shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara). Për sa kohë që autoriteti kontraktor ka gjykuar se kriteret e përcaktuara janë të mjaftueshme për realizimin e kontratës me sukses, ajo në asnjë rast nuk mund të vlerësoj (njësisë së prokurimit) duke shtuar kriteret e tjera kualifikuese për marrjen pjesë në procedurat e prokurimit publik.

III.3. Lidhur me ankesën nr. A/2026/6336, datë 17.02.2026 dhe me nr. protokollin nr. 494/2026 prot., datë 17.02.2026 të operatorit ekonomik “INSTANT.AL” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tyre, me arsyen se: *“Thelbi i çështjes Kriteri 2.3.3/e (DST) kërkon që operatori ekonomik të disponojë të paktën një specialist të certifikuar në Oracle Database Administrator. Në ofertë është paraqitur certifikimi: Oracle Database@AWS Certified Architect Professional (Oracle University), i cili është certifikim në nivel “Professionalë, që verifikon aftësi të avancuara në projektimin, vendosjen (deploying) dhe menaxhimin (managing) të mjediseve Oracle Database@AWS. Po ashtu, në programin përgatitor/strukturën e njohurive përmenden qartë*

fusha si Provision & Operate, HA/DR, Security, si dhe migrimi i Oracle DB on-prem drejt Oracle Database@AWS. Pra, ky certifikim nuk është “vetëm cloud i përgjithshëm, por është certifikim i dedikuar për Oracle Database (me theks në arkitekturë + operim/administrim në një platformë të caktuar), dhe vërteton kompetenca që përputhen drejtpërdrejt me përgjegjësitë tipike të një Oracle DBA (operim, siguri, vazhdimësi, rikuperim, migrim). 2) Pse certifikimi “Oracle Database@AWS Architect Professionalë e përmbush (dhe e tejkalon) kërkesën “Oracle Database Administratorë ? Niveli “Professionalë nënkupton kompetenca të avancuara jo vetëm në konfigurim, por edhe në dizejnim + administrim/operim të zgjidhjes Oracle Database@AWS. ? Përmbajtja e certifikimit përfshin fusha që në praktikë janë thelbësore për administrimin e databazës: operim/provisionim, HA/DR, siguri, migrim (nga on-prem). ? Kërkesa në DST synon të garantojë që operatori ekonomik ka aftësi teknike dhe profesionale për ta realizuar kontratën; një certifikim i avancuar, i lidhur drejtpërdrejt me Oracle Database, e përmbush këtë qëllim. Konkluzion: Certifikimi i paraqitur duhet të konsiderohet ekuivalent ose i nivelit më të lartë krahasuar me një kërkesë “Oracle Database Administratorë në kuptim të kapaciteteve që synon të sigurojë kriteri.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në pikën 2.3 Kapaciteti teknik, pika 2.3.3, të shtojcës 8, “Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar;

#### **“BEHET**

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojë si staf të tij personelin kryesor teknik, si më poshtë:

***h) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E\_SIG të raportuara në zyrat e tatimit taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.***

*Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

***i) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për menaxhim projektsh. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e***

***personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E\_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.***

*Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

- j) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për sisteme operative për servera (Windows Server, Linux) në të cilin do të instalohet platforma e Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E\_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.***

*Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

- k) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për baza të dhënash me të cilën do të ndërtohet databaza e platformës të Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E\_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.***

*Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

- l) Te paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve ëeb/mobile me databazat ekzistuese të institucionit. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E\_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.**

*Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

- m) Të paktën 2 (dy) specialistë, të certifikuar për zhvillimin e programeve ëeb/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E\_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.**

*Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

- n) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për testimin e programeve kompjuterike me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E\_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.**

*Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”,*

*“h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.”*

III.3.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, OE ankimues “INSTANT” SHPK, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

- Operatori ekonomik “Instant” SHPK, Formulari Përmbledhës të Vetdeklarimit, ku për pjesën III “Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit” pika B: “ Deklaratë” Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), ka deklaruar:

Punonjës Po  Jo  Nëse, po, numri i punonjësve: x

Profili i punonjësve Gjithashtu, disponoj personelit kryesor kyc të poshtëshënuar, ne listepagese dhe/ose edhe me kontrata sherbimi, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: Inxhinier elektronik Inxhinier informatik Inxhinier IT Inxhinier Informatik (programues) ETJ.

Specialistet per kete procedure: sipas kërkesave në pikën 2.3.3

a)Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për manaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent.( G.Gj)

b) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për menaxhim projektsh(G.Gj)

c)Të paktën 1 (një) specialist, të çertifikuar për sisteme operative per servera (Windows Server, Linux) në të cilin do të instalohet platforma e Portit digjital (G.Gj)

d)Të paktën 1 (një) specialist, të çertifikuar për baza të dhënash me të cilën do të ndërtohet databaza e platformës të Portit digjital (G.Gj)

e) Te paktën 1 (një) specialist, të çertifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve ëeb/mobile me databazat ekzistuese të institucionit (G.Gj).

f)Të paktën 2 (dy) specialistë, të çertifikuar për zhvillimin e programeve ëeb/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital(G.Gj)(Xh.H)

g)Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për testimin e programeve kompjuterike me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital (G.Gj)

III.3.3 Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë*

*konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

*Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

*Në nenin 77, pika 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*
- Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në*

*ffjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik*

*dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre*

*vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e*

*vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë*

*një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

*Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat*

*dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.3.4. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*

*2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:*

*a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

*b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së*

*c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*

*d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*

*dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*

*e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;*

*g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*

*gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;*

***h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);***

*i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;*

*j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.*

*3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

*4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*

*5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.*

*6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.*

*7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”*

III.3.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të

vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.3.6. Nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet, se autoriteti kontraktor në pikën 2.3.3. të “Kapacitetit teknik” ka kërkuar: *2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojë si staf të tij personelin kryesor teknik, si më poshtë:*

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent.*
- b) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për menaxhim projektesh.*
- c) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për sisteme operative për servera (Windows Server, Linux) në të cilin do të instalohet platforma e Portit digjital.*
- d) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për baza të dhënash me të cilën do të ndërtohet databaza e platformës të Portit digjital.*
- e) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve ëeb/mobile me databazat ekzistuese të institucionit.*
- f) Të paktën 2 (dy) specialistë, të certifikuar për zhvillimin e programeve ëeb/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital.*
- g) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për testimin e programeve kompjuterike me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, konkretisht Formularët Përmbledhës të Vetëdeklarimit, konstatohet, se në lidhje me kërkesën për punonjësit sipas profileve të kërkuara në pikën 2.3.3. të kritereve të veçanata të

kualifikimit, OE ankimues “INSTANT” SHPK ka deklaruar në Pjesën III: *Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit*, B: *DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme* se ka punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërteton këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, sikurse paraqitet edhe në pikën III.3.2. të këtij vendimi e më konkretisht ankimuesi ka deklaruar: 11 punonjës ne total sipas profileve të mëposhtme,

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent. (G.Gj)
- b) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për menaxhim projektsh (G.Gj)
- c) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për sisteme operative per servera (Windows Server, Linux) në të cilin do të instalohet platforma e Portit digjital (G.Gj)
- d) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për baza të dhënash me të cilën do të ndërtohet databaza e platformës të Portit digjital (G.Gj)
- e) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve ëeb/mobile me databazat ekzistuese të institucionit (G.Gj).
- f) Të paktën 2 (dy) specialistë, të certifikuar për zhvillimin e programeve ëeb/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital (G.Gj) (Xh.H)
- g) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për testimin e programeve kompjuterike me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital (G.Gj)

Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 dhe gërma “h” e pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:  
h) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti

Gjithashtu, nga një korrespondencë e mëparshme midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, me shkresën nr. 319/1 prot., datë 19.01.2022 protokolluar me tonën nr. 2472/5 prot., 21.01.2022, Agjencia Prokurimit Publik njofton Komisionin e Prokurimit Publik ndër të tjera se: [....] Kriteri për kualifikim mbi disponimin e punonjësve, duhet të përmbushet, nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas shtojcës 8 të DST. Qëllimi i paraqitjes së deklaratës “Mbi disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme” në këtë shtojcë, është garantimi i ekzekutimit të kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, pra që

*operatori ekonomik ka stafin teknik sipas të dhënave të kërkuara. Referuar sa më sipër, plotësimi i kësaj deklaratë do të jetë në lidhje me numrin e punonjësve, nëse do të jetë kërkuar, dhe profilin e tyre, sipas kërkesave specifike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të një procedure prokurimi [....].*

Nisur nga sa parashtruar më sipër, korrespondencës së kryer me Agjencinë e Prokurimit Publik, të dhënave të deklaruara nga operatori ekonomik ankimues në Formularin e vetdeklarimit në pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika B Deklaratë “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e shërbimeve objekt - kontrate”, Komisioni gjykon se punonjësit e deklaruar të operatorit ekonomik ankimues, kanë të evidentuar të dhënat respektive të kërkuar sipas pikës 2.3.3 të kriterëve të kualifikimit, deklaratë kjo e cila i shërben autoritetit kontraktor për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të kualifikimit për këtë fazë, të vlerësimit të procedurës së prokurimit. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, duhet t’i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në këtë kuadër, Komisioni gjykon, se deklarimi i punonjësve me të dhënat respektive të kërkuar në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, në stadin në të cilin ndodhet procedura e vlerësimit, sjell përmbushjen e kriterëve të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik. Në përfundim të argumentimit të mësipërm, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga OE ankimues “INSTANT” SHPK në procedurën e prokurimit në këtë fazë, e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më sipër, pretendimi i OE ankimues “Instant” SHPK qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Instant” sh.p.k, mbi kundërshtimin e marrjes në shqyrtim të ankesës së shoqërisë IdealDevs Corporation pasi ankesa është bërë pa filluar afati i ankimit, pasi në rastet kur procedura anulohet sipas ligjit të prokurimit publik, afatet fillojnë me publikimin në buletin e njoftimeve publike të APP, ku njoftimi I anulimit të është publikuar në Buletin Nr. 14 datë 16 Shkurt 2026 nderkohe Operatori IdealDevs Corporation ka paraqitur ankesën Data e aplikimit të ankesës online: 15-02-2026 16:52:35 sipas faqes publike të KPP, nuk qëndrojnë, pasi operatorit ekonomik “IdealDevs Corporation” SHPK, ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10

*ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”*, e cila në rastin në fjalë është nga e njesërmja e datës 11.02.2026, prej nga ku autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit me arsyen e se në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme deri në ditën e 7 që i përkonte datës 18.02.2026. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “IdealDevs Corporation” SHPK, ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj nuk përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si lex specialis mbi lëndën. Për sa më sipër, pretendimi i OE ankimues “Instant” SHPK nuk qëndron.

III.5. Lidhur me ankesën nr. A/2026/6338, datë 17.02.2026 dhe me nr. protokollin nr. 499/2026 prot., datë 17.02.2026 e operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së paraqitur prej tyre, me arsyen se: *“Para së gjithash, e konsiderojmë të rëndësishme të risjellim në vëmendje faktin që AK duhet të kryente një vlerësim duke u bazuar vetëm të parashikimet ligjore e nënligjore dhe kriteret e vendosura në dokumentat e tenderit. Cdo derogim nga ky parashikim, përbën një shkelje të ligji dhe cënim të parimit të barazisë në tendera. Legjislatori dhe rregullorebërësi e ka përcaktuar qartë detyrimin e AK për të shqyrtuar brenda kornizave normative dhe kriterëve paraprakisht të vendosura e të bëra në publike...”* Pra referuar bazës ligjore dhe nënligjore, duhet që Autoriteti Kontraktor të kryente vlerësim duke iu referuar vetëm kriterëve që ka përcaktuar vetë në Dokumentat e Tenderit, konkretisht në kriteret e përgjithshme dhe kriteret e vecanta. Nga këqyrja e dokumentave të tenderit, rezulton se AK, ndër të tjera, për cdo certifikim të paraqitur, ka përcaktuar se: *“Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “aë”, “bë”, “dë”, “dhë”, “eë”, “hë”, “ië”, “jë” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në këtë kuptim, duke iu referuar bazës ligjore dhe nënligjore, Autoriteti Kontraktor ka gabuar në vlerësimin e këzre certifikimeve, pasi sipas ligjit, duhet të kërkonte sqarime operatorit ekonomik mbi përmbushjen e kriterëve të vetëdeklaruar, konkretisht certifikatave....* Per te plotësuar kete kriter kemi paraqitur percaktuar tek Formulari Permbledhes I Vetedeklarimit , Pika B Deklarate (për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme)”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.5.1. Në pikën 2.3 Kapaciteti teknik, pika 2.3.3, të shtojcës 8, “Formular i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar;

**“BEHET**

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojë si staf të tij personelin kryesor teknik, si më poshtë:

- o) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E\_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.*

*Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

- p) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për menaxhim projektesh. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E\_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.*

*Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

- q) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për sisteme operative për servera (Windows Server, Linux) në të cilin do të instalohet platforma e Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E\_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.*

*Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

- r) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për baza të dhënash me të cilën do të ndërtohet databaza e platformës të Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes se ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E\_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.**

*Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

- s) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve ëeb/mobile me databazat ekzistuese të institucionit. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes se ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E\_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.**

*Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

- t) Të paktën 2 (dy) specialistë, të certifikuar për zhvillimin e programeve ëeb/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes se ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E\_SIG të**

**raportuara ne zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet te jene te vlefshme. Nje person mund te disponoje nje ose me shume certifikime.**

*Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzoje dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

- u) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për testimin e programeve kompjuterike me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes se ofertave me ofertuesin. Kjo do te vertetohet nga deklarimet E\_SIG te raportuara ne zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet te jene te vlefshme. Nje person mund te disponoje nje ose me shume certifikime.**

*Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzoje dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.”*

III.5.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, OE ankimues “PC STORE” SHPK, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

- Formulari Përmbledhës të Vetdeklarimit, ku për pjesën III “Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit” pika B: “ Deklaratë” Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), ka deklaruar:

Po [ X ] Jo [ ]

Nëse, po, numri i punonjësve: x punonjës

Profili i punonjësve: Administrator, Inxhinier elektronik, Teknik elektronik, etj.

Ne kemi punonjësit e nevojshëm të specializuar/ kualifikuar, si më poshtë:

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për manaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent

R.Sh -ITIL 4 Fundamentals -Essentials of IT Service Management

A.B -ITIL 4 Fundamentals -Essentials of IT Service Management

b) Të paktën 1 (nje) specialist të certifikuar për menaxhim projektsh.

R.Sh -Project Management me Cert ID 323083-159-869-463

c) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për sisteme operative per servera (windows Server, Linux) në të cilin do të instalohet platforma e Portit digjital.

L.Q -Microsoft Certified IT Professional: Enterprise Administrator on Windows Server 2008 c387-3750

d) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për baza të dhënash me të cilën do të ndërtohet databaza e platformës të Portit digjital

A.B -Active Directory Management & Security. One Identity of Experts Nr.152784558 IT Management - Software and Databases ID: 37383333 Databases - DML Statements and SQL Server Administration ID: 1429-37383333

R.K -Technical Specialist One Identity-One Login ID: 236455268 Microsoft Platform Management QUEST.

R.Sh -IT Management - Software and Databases ID: 1758-23570877

L.Q -Microsoft Certified: Azure Administrator Associate : GFB74E-FE542F

e) Te paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve ëeb/mobile me databazat ekzistuese të institucionit.

A.B -Oracle ERP -Fundamental Concepts& Principles ID: 5291-37383333

f) Të paktën 2 (dy) specialistë, të certifikuar për zhvillimin e programeve ëeb/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital.

A.B -Diploma in DevOps Engineering - Kubernetes, Docker and Google Cloud ID: 1696- 37383333 Beginner Ëeb Development Processes and Server Setup ID: 4172-37383333

R.K -Technical Specialist One Identity-One Login ID: 236455268 Microsoft Platform Management QUEST.

R.SH -IT Management - Software and Databases ID: 1758-23570877

L.Q -Microsoft Certified: Azure Administrator Associate : GFB74E-FE542F

g) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për testimin e programeve kompjuterike me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital.

A.B -Diploma in Software Testing ID: 1582-37383333

T.H -Software Tester ID: 069991213724482

III.5.3 Në nenin 2 “*Qëllimi i ligjit*” të ligjit nr. 162/2021 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficientë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Në neni 3 “*Parime të përgjithshme*” të ligjit nr. 162/2021 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

Në nenin 77, pika 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- *a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- *b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- *c) aftësinë teknike dhe profesionale.*
- *Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar*

*kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë*

*një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.5.4. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*

*2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:*

*a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

*b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së*

*c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*

*d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*

*dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*

e)operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë)operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f)operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

**h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);**

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në

*një shtet të huaj Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.*

*7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”*

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.5.6.Nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet, se autoriteti kontraktor në pikën 2.3.3. të “Kapacitetit teknik” ka kërkuar: *2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojë si staf të tij personelin kryesor teknik, si më poshtë:*

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent.*
- b) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për menaxhim projektsh.*

- c) *Të paktën 1 (një) specialist, të çertifikuar për sisteme operative per servera (Windows Server, Linux) në të cilin do të instalohet platforma e Portit digjital.*
- d) *Të paktën 1 (një) specialist, të çertifikuar për baza të dhënash me të cilën do të ndërtohet databaza e platformës të Portit digjital.*
- e) *Te paktën 1 (një) specialist, të çertifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve ëeb/mobile me databazat ekzistuese të institucionit.*
- f) *Të paktën 2 (dy) specialistë, të çertifikuar për zhvillimin e programeve ëeb/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital.*
- g) *Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për testimin e programeve kompjuterike me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes, në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, konkretisht Formularët Përmbledhës të Vetëdeklarimit, konstatohet, se në lidhje me kërkesën për punonjësit sipas profileve të kërkuara në pikën 2.3.3. të kriterëve të veçanata të kualifikimit, OE ankimes “PC STORE” SHPK ka deklaruar në Pjesën III: *Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit* , B: *DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme* se ka punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërteton këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, sikurse paraqitet edhe në pikën III.5.2. të këtij vendimi e më konkretisht ankimesi ka deklaruar: 11 punonjës ne total sipas profileve të mëposhtme,

a) *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent, Rigels Shkambi, A.B.*

b) *Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për menaxhim projektesh, R.SH.*

c) *Të paktën 1 (një) specialist, të çertifikuar për sisteme operative per servera (Windows Server, Linux) në të cilin do të instalohet platforma e Portit digjital, L.Q.*

d) *Të paktën 1 (një) specialist, të çertifikuar për baza të dhënash me të cilën do të ndërtohet databaza e platformës të Portit digjital, A.B.*

*R.K Technical Specialist One Identity-One Login ID: 236455268 Microsoft Platform Management QUEST.R.SH & L.Q.*

e) *Te paktën 1 (një) specialist, të çertifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve web/mobile me databazat ekzistuese të institucionit, A.B.*

f) *Të paktën 2 (dy) specialistë, të çertifikuar për zhvillimin e programeve ëeb/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital. A.B, R.K, R.SH, L.Q.*

g) *Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për testimin e programeve kompjuterike me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital. A.B & T.H.*

Në nenin 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, pika 1 dhe gërma “h” e pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2.*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:*  
h) *operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti*

Gjithashtu, nga një korrespondencë e mëparshme midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, me shkresën nr. 319/1 prot., datë 19.01.2022 protokolluar me tonën nr. 2472/5 prot., 21.01.2022, Agjencia Prokurimit Publik njofton Komisionin e Prokurimit Publik ndër të tjera se: [....] *Kriteri për kualifikim mbi disponimin e punonjësve, duhet të përmbushet, nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas shtojcës 8 të DST. Qëllimi i paraqitjes së deklaratës “Mbi disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme” në këtë shtojcë, është garantimi i ekzekutimit të kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, pra që operatori ekonomik ka stafin teknik sipas të dhënave të kërkuara. **Referuar sa më sipër, plotësimi i kësaj deklaratë do të jetë në lidhje me numrin e punonjësve, nëse do të jetë kërkuar, dhe profilin e tyre, sipas kërkesave specifike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të një procedure prokurimi [....].***

Nisur nga sa parashtruar më sipër, korrespondencës së kryer me Agjencinë e Prokurimit Publik, të dhënave të deklaruara nga operatori ekonomik ankimues në Formularin e vetëdeklarimit në pjesën III: “*Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika B Deklaratë “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e shërbimeve objekt - kontrate*”, Komisioni gjykon se punonjësit e deklaruar të operatorit ekonomik ankimues, kanë të evidentuar të dhënat respektive të kërkuar sipas pikës 2.3.3 të kriterëve të kualifikimit, deklaratë kjo e cila i shërben autoritetit kontraktor për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të kualifikimit për këtë fazë, të vlerësimit të procedurës së prokurimit. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, duhet t’i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave

të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në këtë kuadër, Komisioni gjykon, se deklarimi i punonjësve me të dhënat respektive të kërkuar në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, në stadin në të cilin ndodhet procedura e vlerësimit, sjell përmbushjen e kriterëve të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik. Në përfundim të argumentimit të mësipërm, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga OE ankimes “PC STORE” SHPK në procedurën e prokurimit në këtë fazë, e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më sipër, pretendimi i OE ankimes “PC STORE” SHPK qëndron.

III.6. Lidhur me ankesën nr. A/2026/6339, datë 17.02.2026 dhe me nr. protokollin nr. 504/2026 prot., datë 18.02.2026 e operatorit ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tyre, me arsyen se: *“SE PARI, sic shohim, ne kërkesat e AK per certifikatat e specialisteve nuk ka asnje reference per ndonje organizem/entitet certifikues, per formen apo permbajtjen e certifikimit, per provime apo regjistrime, per kualifikime apo akreditime, per nivele profesionale apo jo profesionale. AK ka kerkuar vetem qe OE te paraqesin certifikime te leshuara nga cdo entitet certifikues, i huaj apo vendas, mjafton qe objekti i certifikimit te jete ai i kerkuar nga AK, duke provuar keshtu se punonjesi i certifikuar ka marre njohuri/eshte specializuar ne fushen/specialitetin e kerkuar ne kriter. AK nuk ka percaktuar as ndonje nivel specifik njohurish, ka kerkuar thjesht certifikime te fushes IT. SE DYTI, ne kriterin per paraqitje te certifikimeve ISO, AK ka percaktuar “2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatat perkatese te vlefshme te ISO-ve, (te perkthyer ne shqip dhe te noterizuara) te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si me poshte:ë. Pra ne rastin kur AK ka dashur te percaktoje kerkesa per akreditimet, i ka percaktuar ato (si ne kriterin 2.3.2). Ne rastin e certifikimeve te specialisteve, AK nuk e ka pare te arsyeshme te percaktoje asnje kerkese ne lidhje me akreditimet apo njohjen e certifikimeve nga organizmat e vleresimit te konformitetit apo nga organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Tani AK nuk mund te ngreje me asnje pretendim mbi akreditime apo kerkesa te tjera qe nuk i ka percaktuar ne DST. SE TRETË, sic shohim, Agjencia e Prokurimit Publik ka monitoruar kete procedure dhe ka nderhyre me sugjerimet dhe rekomandimet e saj prane AK (lidhur me procedurën e prokurimit Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Portë), duke i kerkuar AK te zbatoje detyrimin ligjor per te njohur certifikimet ekuivalente, dhe te mos i referohet asnje enti/marke certifikuese specifikesht, por te njohe te gjitha certifikimet qe kane objekt te njejte me ate qe ka kerkuar AK, pra te njohe ekuivalencen e certifikatave.... Eshte e rendesishme te sqarojme qe AK nuk ngre asnje pretendim per permbajtjen e njohurive qe merren permes ketij certifikimi, por ngre pretendime vetem per anen formale te certifikimit. AK e nis arsyen per skualifikim ecertifikimet profesionale ITIL, sipas standardeve ndërkombëtare të njohura...ë. Nga ketu behet e qarte qe arsyeja per skualifikim nuk bazohet ne kriterin e kerkuar, por ne standarte evazive te papercaktuara, te*

*pabazuar ne ndonje ligj/rregullore/urdherese por thjesht ne nje perceptim/preference te KVO. AK nuk referon asnje organizem kombetar apo nderkombetar te njohur nga ligji shqiptar qe ka percaktuar keto standarte nderkombetare dhe cilat jane konkretisht keto standarte, cila organizate i percaktoi, cila eshte vlere ligjore qe ato kane para ligjeve shqiptare..... Per sa sqaruar me lart, e gjejme skualifikimin tone te pabazuar ne ligj, dhe te pabazuar ne kriteret qe vete AK ka vendosur ne dokumentat e procedures. Ne arsyet per skualifikim AK ka sajuar kerkesa dhe kriteret te paqena, ka ngritur pretendime te cilat nuk mund te ngrihem me tani, pasi ka perfunduar procedura. Theksojme perseri qe AK ne arsyet per skualifikim nuk ngre asnje pretendim per permbajtjen e trajnimeve, pranon se certifikimet e paraqitura kane kurikulen te njejte me cfare eshte kerkuar, pra trajnojne, pergatisin dhe certifikojne punonjesit pikerisht per objektet e certifikimit qe AK ka kerkuar. AK pranon se certifikimet i perkasin fushes se kerkuar. Pretendimet qe ngre AK ne arsyet per skualifikim i perkasin anes formale te certifikimit, nderkohe qe per anen formale nuk kishte asnje percaktim ne kriteret dhe ana formale nuk mund te jete arsye per skualifikim. Gjithashtu nga kriteret ne DST shihet qartesisht qe AK nuk kishte vendosur asnje kufizim dhe ishte i hapur per te pranuar cdo certifikim qe i perket fushes se kerkuar. Nese AK kishte preferenca apo kufizime per entet certifikuese, format e certifikimit, etj, duhej ti kishte shprehur ato ne dokumentat e procedures, ne menyre qe tju jepte mundesine OE te paraqisnin ankesa.... Sjellim ne vemendje se bazuar ne nenin 92 te LPP i ndryshuar, per cdo paqartesi AK duhet te kerkoje sqarime nga OE, perpara se vendose te skualifikoje nje oferte.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.6.1. Në pikën 2.3 Kapaciteti teknik, pika 2.3.3, të shtojcës 8, “Formular i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar;

### **“BEHET**

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojë si staf të tij personelin kryesor teknik, si më poshtë:

- v) ***Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për manaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E\_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Nje person mund te disponoje nje ose me shume certifikime.***

*Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”,*

“h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- w) **Të paktën 1 (nje) specialist të certifikuar për menaxhim projektsh. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes se ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E\_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jene te vlefshme. Nje person mund te disponoje nje ose me shume certifikime.**

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- x) **Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për sisteme operative per servera (Windows Server, Linux) në të cilin do të instalohet platforma e Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes se ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E\_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jene te vlefshme. Nje person mund te disponoje nje ose me shume certifikime.**

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- y) **Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për baza të dhënash me të cilën do të ndërtohet databaza e platformës të Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes se ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E\_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jene te vlefshme. Nje person mund te disponoje nje ose me shume certifikime.**

*Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

- z) Te paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve ëeb/mobile me databazat ekzistuese të institucionit. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E\_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.**

*Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

- aa) Të paktën 2 (dy) specialistë, të certifikuar për zhvillimin e programeve ëeb/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E\_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.**

*Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

- bb) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për testimin e programeve kompjuterike me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E\_SIG të**

***raportuara ne zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet te jene te vlefshme. Nje person mund te disponoje nje ose me shume certifikime.***

*Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.”*

III.6.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, OE ankimues “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

- Formulari Përmbledhës të Vetdeklarimit, ku për pjesën III “Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit” pika B: “ Deklaratë” Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), ka deklaruar:

Punonjës Po  Jo  Nëse, po, numri i punonjësve: x

Profili i punonjësve Dizenjator grafik, IT, Matematike, Sipermarres, Punonjes zyre, Sherbime ndihmese, Specialist koordinimi, Specialist marketingu, etj.

E.R – administrator - inxhinjer elektronik - diplome Universiteti Politeknik Tirane - Dega Elektronike, me certifikimet si me poshte:

Pika a)

Certifikim ITIL nga xxxxxx

Certifikim per suport teknik nga xxxxxx

Pika b)

Certifikim per hartim dhe menaxhim projektesh nga xxxxx

Certifikim per menaxhim prokektesh nga xxxxxxxx

Certifikim per menaxhim projektesh nga xxxxxxxxxxxx

Certifikim per menaxhim projektesh nga xxxxxxxx

Certifikim per menaxhim projektesh nga xxxxxxxx

Certifikim per menaxhim projektesh nga xxxxxxxxxxxx

Pika c)

Certifikim per sistemet operative dhe servera Linux nga xxxxxxxx

Pika d)

Certifikim Administrator database nga xxxxxxxx

Pika e)

Certifikim per administrimin e databazave oracle nga xxxxxxxx

Certifikim per administrimin e programeve ëeb dhe mobile nga xxxxxxxx

Pika f)

Certifikim zhvillues aplikacionesh platformash ëeb Umbraco nga xxxxx

Certifikim zhvillues ëeb, CSS3 dhe HTML5 nga xxxxxxx

Certifikim UX Design nga Google Coursera xxxxxxx

Pika g)

Certifikim Software testing nga xxxxxxxx

Certifikim Software arkitecture nga xxxxxxxx

Certifikim cybersecurity nga xxxxxxxx

Certifikim Software testing nga xxxxxxxx

Pika d)

E.B - e diplomuar ne Universitetin e Tiranës – Fakulteti i Shkencave Natyrore – Dega Matematike – punonjese e Optima Communication sh.p.k.

Certifikim inxhinjer database nga xxxxxxxx

Pika f)

Mbeshtetje te subjekti Endri Dulellari Person Fizik – E.D – i diplomuar Universiteti I Arteve

Certifikim zhvillues ëeb nga xxxxxxxx

Shoqeruar me angazhimin me shkrim te subjektit

*Shenim: per te gjitha deklarimet e mesiperme jemi te gatshem te paraqesim certifikimet dhe listepagesen e muajit te fundit te maturuar sipas ligjit, nga data e hapjes se ofertave, ashtu sic eshte percaktuar ne kerkesat e procedures.*

III.6.3 Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

Në nenin 77, pika 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- *a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- *b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- *c) aftësinë teknike dhe profesionale.*
- *Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre

vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e

vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë

një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si

*dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.6.4. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*

*2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:*

*a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

*b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së*

*c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*

*d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*

*dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*

*e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori*

ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f)operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

**h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);**

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

*7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”*

III.6.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.6.Nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet, se autoriteti kontraktor në pikën 2.3.3. të “Kapacitetit teknik” ka kërkuar: *2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojë si staf të tij personelin kryesor teknik, si më poshtë:*

- h) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent.*
- i) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për menaxhim projektesh.*
- j) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për sisteme operative për servera (Windows Server, Linux) në të cilin do të instalohet platforma e Portit digjital.*
- k) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për baza të dhënash me të cilën do të ndërtohet databaza e platformës të Portit digjital.*

- l) Te paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve ëeb/mobile me databazat ekzistuese të institucionit.*
- m) Të paktën 2 (dy) specialistë, të certifikuar për zhvillimin e programeve ëeb/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital.*
- n) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për testimin e programeve kompjuterike me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, konkretisht Formularët Përmbledhës të Vetëdeklarimit, konstatohet, se në lidhje me kërkesën për punonjësit sipas profileve të kërkuara në pikën 2.3.3. të kriterëve të veçanata të kualifikimit, OE ankimues “INSTANT” SHPK ka deklaruar në Pjesën III: *Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit*, B: *DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme* se ka punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërteton këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, sikurse paraqitet edhe në pikën III.6.2. të këtij vendimi e më konkretisht ankimuesi ka deklaruar: 9 punonjës ne total sipas profileve të sipercituar në pikën III.6.2.

Në nenin 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, pika 1 dhe gërma “h” e pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

*2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:*  
 h) *operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti*

Gjithashtu, nga një korrespondencë e mëparshme midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, me shkresën nr. 319/1 prot., datë 19.01.2022 protokolluar me tonën nr. 2472/5 prot., 21.01.2022, Agjencia Prokurimit Publik njofton Komisionin e Prokurimit Publik ndër të tjera se: *[....] Kriteri për kualifikim mbi disponimin e punonjësve, duhet të përmbushet, nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas shtojcës 8 të DST. Qëllimi i paraqitjes së deklaratës “Mbi disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme” në këtë shtojcë, është garantimi i ekzekutimit të kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, pra që operatori ekonomik ka stafin teknik sipas të dhënave të kërkuara. Referuar sa më sipër, plotësimi i kësaj deklaratë do të jetë në lidhje me numrin e punonjësve, nëse do të jetë kërkuar, dhe profilin e tyre, sipas kërkesave specifike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të një procedure prokurimi [....].*

Nisur nga sa parashtruar më sipër, korrespondencës së kryer me Agjencinë e Prokurimit Publik, të dhënave të deklaruara nga operatori ekonomik ankimues në Formularin e vetdeklarimit në pjesën III: *“Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika B Deklaratë “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e shërbimeve objekt - kontrate”*, Komisioni gjykon se punonjësit e deklaruar të operatorit ekonomik ankimues, kanë të evidentuar të dhënat respektive të kërkuar sipas pikës 2.3.3 të kriterëve të kualifikimit, deklaratë kjo e cila i shërben autoritetit kontraktor për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të kualifikimit për këtë fazë, të vlerësimit të procedurës së prokurimit. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, duhet t’i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar. Në këtë kuadër, Komisioni gjykon, se deklarimi i punonjësve me të dhënat respektive të kërkuar në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, në stadin në të cilin ndodhet procedura e vlerësimit, sjell përmbushjen e kriterëve të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik. Në përfundim të argumentimit të mësipërm, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga OE ankimues *“OPTIMA COMMUNICATION”* SHPK në procedurën e prokurimit në këtë fazë, e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më sipër, pretendimi i OE ankimues *“OPTIMA COMMUNICATION”* SHPK qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues *“OPTIMA COMMUNICATION”* SHPK, mbi lenien të skualifikuar të OE Idealdevs Corporation, PC Store, Atom, Instant, pasi skualifikimi i tyre është bere për arsye se certifikimet kanë mangesi në përmbajtje, nuk mbulojnë fushat e kerkuara, personat e trajnuar nuk kanë marrë njohurite e duhura në fushat e kerkuara KPP gjykon se për sa kohë lidhur me arsyet e skualifikimit të operatoreve ekonomik Idealdevs Corporation, PC Store, Instant është shprehur në kete vendimin si me sipercituar vlen të mos ripërsëris veten për të njëjtat pretendime të gjykuara me lart. Përsa i përket operatorit ekonomik Atom Shpk për sa kohë ky operator nuk ka paraqitur ankesë dhe as argumenta fati i tij do vazhdojë të mbetet i njëjtë pra i sakualifikuar duke e përmbushur qëllimin e vetë pretendimit të ankimesit dhe akoma më tej pa asnjë ndikim mbi fatin e çështjes.

III.8. Lidhur me pretendimin tjetër të operatorit ekonomik *“OPTIMA COMMUNICATION”* SHPK, me arsyetimin se: *“në përfundim të procesit të ankimit, duke parë cilet OE do të rezultojnë të kualifikuar, me shumë mundësi OE i renditur i pari (Idealdevs Corporation), por me gjasa edhe ai i renditur i dyti (PC Store), mund të rezultojnë oferta anomalisht të uleta, gje që sjell skualifikimin e tyre”*, KPP gjykon se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk do të merren

në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, gjendja faktike dhe juridike e këtij operatorëve ekonomik do të ndryshojë pas ankimit në KPP, dhe autoriteti kontraktor do të rivlersojë ofertat dhe për rrjedhojë do të ri-aplikojë menyrën e e përlllogaritjes së ofetës anomalisht të ulët sipas nenit 82 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, pretendimi i OE ankimues “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK nuk do te merret ne shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e BOE “Idealdevs Corporation” SHPK & “Ervald Rosaj” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02-02-2026 , nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durres.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Instant” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “PC Store” SHPK, për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
4. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK, për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
5. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
6. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
7. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Idealdevs Corporation” SHPK & “Ervald Rosaj” SHPK, nga operatori ekonomik

“Instant” SHPK, nga operatori ekonomik “PC Store” SHPK si dhe nga operatori ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK.

8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

